



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:239363
Datë: 31.10.2024
Numri i dokumentit: 06380633

Në çështjen juridike të: AC-I-24-0743-A0001

Paditës/Ankues

A G sh.p.k, me pronar E A, me përfaqësues sipas autorizimin avokatin A H, Prishtinë.

Kundër :

E paditur

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-I-24-0034, të datës 20 shtator 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
- Vërtetohet Aktvendimi i Kolegjit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-I-24-0034, i datës 20 shtator 2024.
- Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 30 gusht 2024, paditësi kishte paraqitur një padi më propozim për caktimin e masës së sigurisë. Në padi kishte theksuar se e paditura në valën e 37-të të privatizimit e kishte tenderuar asetin përkatësisht hapësirën afariste me sipërfaqe prej 267.64 m², e cila gjendet në katin përdhese të ndërtesës në lagjen Dardania rr. “..”, Prishtinë, në pronësi të N.SH “Agrokosova” dhe në proces të ofertimit kishin marrë pjesë gjashtë ofertues dhe ofertuesi me çmimin më të lartë ishte shpallur tani paditësi “..” sh.p.k, me seli në Prishtinë me çmimin prej 321,111.00 euro dhe se çmimi ishte miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30 shtator dhe 1 tetor 2009.

E paditura nuk kishte mundur të vazhdoj me procedurat për përmbylljen e shitjes për shkak se DHPGJS me Aktvendimin SCC-09-0151 të datës 27 tetor 2009 ia kishte ndaluar AKP-së të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me privatizimin e ndërmarrjes së re “Agrokosova” e tenderuar në valën e 37 të Privatizimit. Për shkak se procesi për përmbylljen e shitjes ishte vonuar, paditësja me shkresën e datës 7 mars 2011 kishte kërkuar nga e paditura që të njoftohej lidhur me procesin e përmbylljes së privatizimit për asetin lëndor dhe njëherit kishte shprehur interesim që ky proces të përfundoj sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Me datë 23 mars 2011 e paditura ishte përgjigjur duke theksuar se përderisa është në fuqi vendimi i DHPGJS-së për masë të sigurisë nuk mund të përfundohet privatizimi dhe se krejt ky proces është në varësi të vendimit meritor që do të nxjerri DHPGJS-ja. Përderisa paditësi ishte në pritje të informimi nga AKP-ja rreth përmbylljes së procesit të privatizimit për lokalin afarist në fjalë nga ueb faqja e AKP-së por edhe nga mjetet tjera të informimit kishte rënë në dijeni se është tenderuar lokali afarist kontestues me sipërfaqe prej 267.64 m², i cili gjendet në katin e parë të objektit të banimit me etazhitetin P+1, rr. “..” në lagjen D në Prishtinë, përkatësisht Njësia nr.27, shitja e aseteve në likuidim (SHAL) nr.68. Paditësi në rastin konkret përmes një shkrese kishte kërkuar tërheqjen nga shitja të njësisë në fjalë si dhe përmbylljen e procesit të privatizimit duke u bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 30 shtator dhe 1 tetor 2009, mirëpo e paditura nuk ishte përgjigjur në shkresën e paditësit dhe se deri më tani nuk e kishte tërhequr nga shitja asetin në fjalë.

Prandaj, paditësi konsideron se një qasje e tillë e të paditurës ku i lejon vetes një diskrecion kaq të hapur pa ofruar kurrfarë arsytimi ose së paku duke mos iu referuar asnjë baze juridike për ri

tenderimin e asetit përderisa ekziston vendimi i të paditurës për aprovimin e çmimit të shitjes përveç që dëmton vet procesin e privatizimit për më tepër krijon edhe pasiguri juridike tek investitorët potencial e poashtu ndikon edhe në interesat e palëve të përfshira si dhe është në kundërshtim edhe me vet dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë paditësi i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit të aprovohet si e bazuar, të detyrohet e paditura që në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të datës 30 shtator dhe 1 tetor 2009 të vazhdoj procedurat e shitjes, respektivisht përmbylljen e kontratës me paditësin për lokalin afarist me sipërfaqe prej 267.64 m2 në pronësi të N.SH “Agrokosova”, i cili gjendet në katin e parë të objektit të banimit në rr. “..”, lagjja Dardania, Prishtinë si dhe të detyrohet e paditura që t’i paguaj shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit.

Gjithashtu, paditësi në propozimin për caktimin e masës së sigurimit kishte theksuar se në rastin konkret masa e sigurisë është e vetmja garanci ligjore për sigurimin e kërkesëpadiisë e cila është objekt kontesti në këtë procedurë civile dhe se caktimi i masës së sigurisë nuk e dëmton asnjëherë nga palët në procedurë por e njëjta është një garanci juridike për sigurimin e kërkesëpadiisë.

Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të caktohet masa e sigurisë me të cilën t’i ndalohet kundërshtares së sigurimit, AKP-së që të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me vazhdimin e procedurave të tenderimit publik për Njësinë 27, SHAL 68, përfshirë shitblerjen-bartjen e pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë dhe peng, ndërtim si dhe çfarëdo ndryshimi tjetër për lokalin afarist me sipërfaqe prej 267.64 m2 në pronësi të N.SH “Agrokosova” i cili gjendet në katin e parë të objektit të banimit në rr. “..”, lagjja D, Prishtinë.

Padisë dhe propozimit i kishte bashkëngjitur këto prova: Memorandumin e datës 21 dhjetor 2022 me lëndë Transaksionet e Valës 37, Aktvendimin e DHPGJS-së SCC-09-0151 të datës 27 tetor 2009, Kërkesë për sqarim të datës 7 mars 2011 nga “A G” sh.p.k, Përgjigje në kërkesën për informacion lidhur me procesin e privatizimit të N.SH “Agrokosova” nga AKP, e datës 23 mars 2011, kërkesë për tërheqje nga shitja të Njësisë nr. 27 e paraparë në SHAL nr. 68 si dhe përmbyllja e privatizimit në pajtim me vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 30 shtator dhe 1 tetor 2009, të dhënat për asetin, raport mbi vizitën e njësisë Agrokosova, zyrat në Dardani i datës 9 korrik 2024 si dhe një autorizim për përfaqësim.

Me datë 16 shtator 2024, e paditura/kundërshtarja e sigurimit kishte paraqitur përgjigje në padi dhe në kërkesën për masë sigurie. Në përgjigje ishte theksuar se lidhur me propozimin për masë të përkohshme konsideron se në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet propozimi si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, e të cilat mjete sipas mundësive propozuesi duhet t'ia bashkëngjisë propozimit për caktimin e masës së përkohshme. Andaj në rastin konkret kishte konsideruar se nuk është përmbushur kriteri për lëshimin e masës së përkohshme në mënyrë të qartë siç është përcaktuar në nenin 66.1 të DHPGJS-së.

Parashtruesi në kërkesën për masë sigurie duhet të paraqes një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme të rrethanave faktike prej të cilave mund të nxirret përfundimi se ekziston dëmi gjithëpërfshirës i cili është i menjëhershëm dhe i pariparueshëm. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar padia e paditësit dhe të hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa e propozuesit të sigurimit apo në të kundërtën të refuzohet si e pabazuar në ligj. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur: vendimin me nr.Ref.BD-204/70 të datës 27 qershor 2024, një shkresë e datës 18 nëntor 2009 nga AKP, Memorandumin për Bordin e Drejtorëve të datës 19 qershor 2024 si dhe disa të dhëna për biznesin në ARBK.

Me datë 20 shtator 2024, Kolegji i shkallës së parë të DHPGJS-së me Aktvendimin C-I-24-0034 kishte refuzuar si të pabazuar propozimin e paditësit. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi gjykata kishte theksuar se masa e sigurimit në rastin konkret nuk mund të caktohet për t'u rivendosur gjendja e mëparshme e cila gjendje ka pushuar së ekzistuari me shfuqizimin e vendimit të BD të datës 30 shtator dhe 1 tetor 2009, çështja është e përfunduar tërësisht ndërmjet palëve dhe nuk mund të krijohet një marrëdhënie e re detyrimi përmes masës së sigurimit. Andaj gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe pas analizimit të provave prezente në lëndë kishte ardhur në përfundim se pretendimet e paditësit për caktimin e masës së sigurimit janë të pabazuara, pra i njëjti nuk e ka bërë të besueshme se mos caktimi i një mase të tillë do t'i shkaktoj dëme të pariparueshme dhe të pakompensueshme në të ardhmen. Kjo gjykatë kishte vlerësuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore konform dispozitave ligjore të lartcekura për një masë të tillë dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Me datë 27 shtator 2024, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktvendimit C-I-24-0034 të datës 20 shtator 2024 (Aktvendimi i ankimuar), për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i

propozuar Kolegjit të Apelit që të aprovet ankesa e ankuesit dhe të ndryshohet Aktvendimi i ankimuar ashtu që të caktohet masa e sigurisë ndaj kundërshtares së sigurimit dhe t'i ndalohej të paditurës që të ndërmarrë çfarëdo veprimi lidhur me vazhdimin e procedurave të tenderimit publik për Njësinë 27, SHAL 68, përfshirë shitblerjen-bartjen e pronësisë në persona të tretë, lënien në hipotekë si dhe çfarëdo ndryshimi tjetër për lokalin afarist me sipërfaqe prej 267.64 m², në pronësi të N.SH "Agrokosova", që gjendet në katin e parë të objektit të banimit në rr. "...", lagjja D, Prishtinë si dhe të mbetet në fuqi masa e sigurisë derisa e njëjta të mos jetë revokuar me Aktvendim të veçantë ose me Aktgjykim meritore të gjykatës së çështjes.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës konsistojnë në faktin se në arsyetimin e aktvendimit nuk janë paraqitur arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare kurse arsyet e paraqitura janë kundërthënëse me përmbajtjen e provave të shqyrtuara. Aktvendimi i ankimuar në rastin konkret është i përgjithësuar, pa përmbajtje duke i anashkaluar provat dhe faktet e propozuara dhe si i tillë është marrë në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 4, nënparagrafi 2 i LDHP-së që parasheh se çdo vendim duhet të përmbaj prezantimin e gjetjeve faktike që janë me rëndësi materiale për rastin e që është objekt i vendimit. Si pasojë e shkeljeve të dispozitave procedurale natyrshëm, gjykata ka ardhur deri te konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sepse nuk i ka analizuar provat që gjenden në shkresa të lënës. Referuar rrethanave se paditësi do të pësojë dëm të menjëhershëm argumentohet përmes faktit se e paditura ka tenderuar asetin në fjalë.

Duke e pasur parasysh natyrën e padisë së parashtruar nëse aset i lëndor shitet, padisë do t'i humbiste kuptimi. Rrjedhimisht çdo dëm në një formë apo tjetër parimisht do të mund të zhdëmtohej me anë të një kompensimi financiar. Fakti që gjykata kishte konstatuar se me shfuqizimin e vendimit të Bordit të AKP-së të datës 30 shtator dhe 1 tetor 2009 çështja ka përfunduar ndërmjet palëve dhe se nuk mund të krijohet një marrëdhënie e re detyrimi përmes masës së sigurisë, konsiderohet vlerësim jo i drejtë dhe kontradiktor me provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës. Paditësi në vazhdimësi kishte shprehur interes dhe disa herë përmes shkresave të cilat gjykata i ka në dispozicion kishte kërkuar nga e paditura që të njoftohej lidhur me procesin e përmbjlljes së privatizimit për asetin lëndor. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë, ankuesi i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë.

Me datë 14 tetor 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e ankuesit në të cilën kishte theksuar se pretendimet e paraqitura në ankesë nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte

materiale që do të ishin relevante për rastin konkret dhe se mungesat e tilla ankesën e bëjnë të paqëndrueshme. Andaj, i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kriteret se kur duhet të lëshohet masa e sigurisë përcaktohen në nenin 61 së Ligjit për Dhomën e Posaçme: Pala duhet të ofrojë dëshmi të besueshme se do të rezultojë me humbje dhe dëmtim të drejtpërdrejtë dhe të pariparueshëm vetëm nëse ai nuk mund të kompensohet në mënyrë të arsyeshme me ndonjë kompensim financiar nëse nuk miratohet kërkesa. Këto kritere janë përcaktuar në atë mënyrë që nëse ndonjëra nga të mësipërmet mungon, kërkesa do të refuzohet.

Kërkesa për dëshmi të besueshme i përmban që të dyja: *fumus boni iuris* (propabiliteti se ekziston e drejta e kërkuar = presupozimi i bazës së mjaftueshme ligjore), dhe *periculum in mora* (rreziku i dëmtimit i pashmangshëm dhe i pariparueshëm ndaj kësaj të drejte), pasi që humbja dhe dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm mund të ndodhë vetëm nëse ekziston në të vërtetë e drejta e pretenduar (shih jurisprudencën e përhershme të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së: cf., inter alia, ASC-10-0079, ASC-10-0081, ASC-10-0017, ASC-10-0049, ASC-10-0088).

Kolegji i Apelit konstaton se Aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Paditësi, në këtë fazë të procedurës nuk ka ofruar dëshmi që tregojnë se dëmi i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, ekziston në rast se nuk caktohet urdhri paraprak gjyqësor. Për më tepër në shkresat e lëndës si dhe nga deklaratat e vet palëve, Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së i datës 30 shtator dhe 01 tetor 2009 për aprovimin e shitjes së Ndërmarrjes së Re “Agro Kosova”, Zyret e SHPK-së për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore ishte Shfuqizuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 27 qershor 2024 dhe ky aset do të ri tenderohet ne fazat e mëvonshme.

Kolegji i Apelit vëren sipas thënieve të vetë paditësit se me 19/02/2016 me Aktvendim ishte hequr masa e sigurisë. Që nga ajo kohë paditësi nuk kishin ndërmarre asnjë veprim në drejtim të përfundimit të Kontratës ai kishte heshtur edhe pse ishte shpallur fitues i përkohshëm . Në shkresat e lëndës të prezantuara nga paditësi, komunikimi i fundit ndërmjet paditësit dhe AKP-së është i datës 07 mars 2011.

Në këtë rast AKP-ja për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore ishte Shfuqizuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 27 qershor 2024 dhe kishte vendosur ritenderimin e asetit në fjalë.

Sidoqoftë paditësi ka mundësi dhe të drejtë që përsëri të paraqesë ofertën e vetë në valën e re të Shitjes Shal 68 , njësia 27.

Për më tepër, gjykata nuk ka autorizime ligjore ta detyron të paditurën që të lidhë kontratë me asnjë palë në këtë rast as me të paditësit.

Prandaj, konstatimi i Kolegjit të shkallës së parë se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 61 të LDHP-së 06/L-086 për të caktuar masën e sigurimit është i saktë dhe si i tillë pranohet edhe nga Kolegji i Apelit.

Për arsyet e lartë theksuara, Kolegji i Apelit e vërteton Aktvendimin e ankimuar të Kolegjit të shkallës së parë, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

Ky Aktvendim në asnjë mënyrë nuk prejudikon zgjidhjen përfundimtare të padisë.

Nga sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____